

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 3-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 15.01.2024**

**Anëtarë e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Arben Saiti, mr. Gorjan Shekerinov, Maja Damevska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 11.01.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 2-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 11.01.2024.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup.
4. Propozim-vendim për dhënie të ndihmës financiare - donacion për Asociacionin e qytetarëve Laboratorit të Raportimit Investigativ - LRI Shkup dhe Propozim - kontratë për donacion.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës të furnizimit publik - mallrat: Pajisjet TIK.
6. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga Seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 11.01.2024, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 2-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 11.01.2024, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup. Ai ka shpjeguar se me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, Agjencia me shkresë iu drejtua të gjithë transmetuesve që të dorëzojnë dokumentacionin për të konfirmuar nëse kanë vepruar sipas ndryshimeve. Nga transmetuesi në fjalë është kërkuar që me datë 09.10.2024 të dorëzojë dokumentacionin përkatës, por posta ia ka kthyer shkresën Agjencisë. Është bërë tentativë që ta dorëzojnë sërish, dhe më pas kërkesa është dërguar në adresën e tyre zyrtare të e-mailit e cila është paraqitur dhe në Agjenci dhe më pas është kontaktuar me telefon me një të punësuar të transmetuesit. Ai ka deklaruar se përfshirë dhe ditën e sotme nuk ka ardhur asnjë dokumentacion nga ana e radios me të cilin mund të konfirmojë se i plotëson kushtet minimale kadrovike sipas Rregullores, që në fakt paraqet bazë për kryerjen e veprimtarisë. Nisur nga kjo situatë, propozohet fillimi i procedurës për heqjen e lejes. Pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj, do të bëhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse do të ndërpritet procedura apo do t'i hiqet leja këtij transmetuesi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023, për faktin se nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm nga i cili mund të konstatohet se i plotësoni kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren e mësipërme, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-78 datë 07.09.2023, për shkak të shkeljes së nenit 62 paragrafi (6) të LSHMAAV dhe nenit 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5 dhe neni 83 paragrafi (3) të LSHMAAV.

Z. Petrushevski propozoi që shërbimi të vazhdojë me përpjekjet për të kontaktuar me transmetuesin për të dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm në 15 ditët e ardhshme për të mos i hequr lejen.

#### **Pika 4**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për dhënien e ndihmës financiare - donacion për Asociacionin e qytetarëve Laboratorit të Raportimit Investigativ - LRI Shkup dhe Propozim - kontratën për donacion. Ai shpjegoi se drejtuar Agjencisë nga ana e Laboratorit të Raportimit Investigativ - LRI Shkup, është dorëzuar kërkesë për donacion në vlerë prej 5.000.000,00 denarë. Ai tha se LRI është e njohur për publikun për përpilimin e teksteve, artikujve, dokumentarëve që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit, krimin dhe qeverisjes së mirë. Ai shpjegoi se periudhën e kaluar ka hapur (trajtuar) temat me rëndësi më të madhe për publikun gjatë gjashtë viteve të ekzistencës së tyre. Nga ana tjetër, një nga detyrat themelore të Agjencisë është që të kujdeset për zhvillimin e pluralizmit në media, dhe kjo përfshin jo vetëm pluralizmin në pronësi, por edhe pluralizmin në raportim. Një nga segmentet e saj të rëndësishme është gazetaria investigative, e cila mungon në mënyrë dramatike në shoqërinë tonë. Duke qenë se produktet e prodhuara nga Laboratori i Raportimit Investigativ transmetohen si kooproduksion (bashkëprodhim) të shërbimit publik, në këtë mënyrë në mënyrë direkte i ndihmohet dhe TVM-së për pasurimin e ofertës programore. Donacioni për të cilin do të votojë Këshilli, gjegjësisht Kontrata për donacion do të nënshkruhet, por më pas do të dërgohet në Ministrinë e Drejtësisë ku duhet të merret mendim pozitiv për ekzistimin e interesit publik. Nëse merret mendim pozitiv nga ministria, mjetet (fondet) do të kalojnë në llogarinë e LRI-së, në të kundërt ASHMA nuk do të mund ta realizojë këtë donacion.

Z. Petrushevski deklaroi se do ta mbështesë propozimin dhe theksoi që nga pranuesi i donacionit pret që edhe më tej të vazhdojë të përmbushë plotësisht standardet profesionale gazetareske dhe t'i përmbahet parimeve me të cilat Agjencia dhe shumica e mediave në vendin tonë punojnë, përkatësisht saktësi të informacionit, paanshmërisë në hulumtimet e tij dhe pavarësi të veprimtaris së tij. Ai beson se këto kërkesa janë normale dhe të pritshme.

Z. Ajdini tha duke u nisur nga fakti se lufta kundër korrupsionit dhe lufta për sundimin e së drejtës është shumë e rëndësishme për shoqërinë, por për këtë para së gjithash duhet dituri, mund dhe guxim. Në rrëfimet e LRI-së që publiku pati mundësinë të shihte, është investuar shumë mund, shumë dituri dhe guxim. Në kërkesë janë theksuar qëllimet e tyre të cilat ne i dimë, si dhe partnerët e tyre, kështu që Këshilli e di pse do ta votojë donacionin. Ai deklaroi se do ta mbështesë propozimin.

Z. Fidanoski tha se gjatë diskutimit u përmend se një nga qëllimet tona është të inkurajojmë zhvillimin e mediave në vend si trup rregullator. Drejtori Trajçevski përmendi, se vetëm do të shtojë se gazetaria investigative sipas tij, pasi që në atë profesion ka punuar më shumë se dy dekada, është në krye të profesionit të gazetarisë dhe fatkeqësisht ka rënë dukshëm në vitet e fundit sepse ka nevojë për financim të projekteve investigative (hulumtuese). Ai deklaroi se do të japë mbështetje të plotë për këtë pikë. Ai theksoi se kohëve të fundit, nga të gjitha sugjerimet, pjesa më e madhe e sugjerimeve të përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për atë se cili është problemi themelor në shoqërinë e maqedonisë, vendin e parë në këtë ranglistë e ka korrupsioni. Ai tha dramatike janë apelet nga bashkësia ndërkombëtare për atë se si ne si shtet dhe si shoqëri përballemi ose më mirë nuk përballemi. LRI është redaksi që trajton temat që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe në këtë drejtim ai beson se donacioni i propozuar do t'i ndihmojë që të vazhdojnë të punojnë në atë drejtim. Dhe siç tha z. Petrushevski, ai pajtohet se duhet të respektohen të gjitha standardet profesionale, siç është saktësia, pa subjektivitet dhe anshmëri, profesionalizëm në punën e tyre dhe beson se vetëm në këtë mënyrë rezultatet do të vijnë në vend.

Z. Trajçevski shpjegoi se në dokumentet strategjike të Agjencisë viteve të fundit, theksohet, se Agjencia është e vendosur për formimin e një Fond për mediat që do të mbështesë pikërisht projekte të tilla. Ky është tani një shembull që do t'i tregohet publikut se si duhet të funksionojë ai Fond. Ai shpjegoi se ndoshta kjo do të nxisë një diskutim rreth formimit të tij.

Z. Petrushevski tha se pret që në të ardhmen të paraqiten dhe parashtrues të tjerë për këtë temë kështu që zgjidhja të shkojë në drejtim siç tha z. Trajçevski dhe nga diskutimet e mëparshme, të formohet një Fond për mediat në nivel shtetëror, që Agjencia ose trup tjetër do ta kanalizojë dhe do të shkojë drejt projekteve të tilla të ngjajshme në fushën e medias.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi vendimin për dhënien e ndihmës financiare – donacion për Asociacionin e qytetarëve Laboratorit të Raportimit Investigativ – LRI Shkup, në vlerë prej 5.000.000,00 (pesë milionë) denarë, me qëllim për sigurimin e realizimit të iniciativave të saj në të ardhmen investigative (hulumtuese), duke rritur volumin dhe cilësinë e përmbajtjeve që prodhon, fokusi i së cilës është lufta kundër korrupsionit dhe lufta kundër dezinformimit, duke mbështetur punën e saj për përmirësimin e tregut mediatik dhe krijimin e stafit shtesë që do të prodhojë përmbajtje sipas standardeve më të larta profesionale ndërkombëtare, si dhe në zbatimin e modelit inovativ të rrëfimit multimedial të investigimit cilësor dhe të pavarur, i cili do të sjellë rritjen e besimit në media dhe përmirësimin e arsimimit mediatik në vend, si dhe nëpërmjet njoftimeve për tema të rëndësishme për qytetarët, që do t'u japë ndihmë që të marrin vendime të informuara - propagandë politike gjatë zgjedhjeve dhe sundim i së drejtës.

Mjetet financiare janë të parapara në Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024 dhe janë paguar në llogarinë e LRI Shkup: 300-0000041683-20, depozituesi i Bankës komerciale SHA Shkup, me numër tatimor 4032018536475.

Për ndihmën e dhënë financiare-donacion nga vendimi i lartpërmendur, lidhet kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Asociacionit të qytetarëve Laboratorit të Raportimit Investigativ - LRI Shkup, e cila do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese, dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV-së.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

## **Pika 5**

Z. Trajçevski bëri një hyrje të Propozimit për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës të furnizimit publik - mallra: pajisje TIK. Ai shpjegoi se furnizimi është pjesërisht i lidhur me zbatimin e dy proceseve zgjedhore në vijim. Bëhet fjalë për pajisje që do të nevojiten për realizimin e aktiviteteve lidhur me zgjedhjet.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se furnizimi është paraparë në Planin për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2024, ndërsa mjetet janë siguruar nga plani financiar i Agjencisë për vitin 2024. Sipas shumës së parashikuar, furnizimi do të kryhet si procedurë e hapur duke zbatuar dispozitat e Ligjit për furnizim publik, përkatësisht shpallja do të publikohet në sistemin elektronik për furnizim publik dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së..

Udhëheqësi i Sektorit për mbështetje informatike dhe punë të përgjithshme mr. Arben Saiti shpjegoi se përveç pajisjeve që do të përdoren për zgjedhjet e ardhshme, kjo paraqet

edhe një hap drejt modernizimit të pajisjeve TIK të Agjencisë. Ai tha se specifikimi teknik është i ndarë në dy pjesë dhe planifikohet të sigurohen pajisje që do të ketë rolin e mbrojtjes së të dhënave të Agjencisë, veçanërisht nga “ransomware”, që si sektor vlerësoan se duhet të kryhet furnizimi. Pjesa e dytë është furnizimi (blerja) e kompjuterëve personalë, disa prej të cilëve janë fikse e disa të lëvizshëm(celular). Specifikimi përmban kërkesat minimale që janë të nevojshme të plotësojnë operatorët ekonomikë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik të mallrave: pajisje TIK.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën - mallra pajisje TIK është paraparë dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

## **Pika 6**

### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**